

ERNEST BUSHATI*(1912-1993)***SELFO L., HAXHIMIHALI DH.**

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Natyrore, Departamenti i Kimisë Industriale

Ernest Bushati është ndër kimistët dhe pedagogët e shquar të vendit tonë, që për më tepër se 40 vjet punoi me përkushtim dhe profesionalizëm të lartë për ngritjen dhe zhvillimin e industrisë kimike në vendin tonë. Lindi në Shkodër në dhjetor 1912 në një familje me tradita të vjetra qytetare. Shkollën fillore e kreu në qytetin e lindjes, e po këtu kreu shkollën e mesme, në kolegjin e njohur të jezuitëve, me rezultate të larta. Me shpenzimet e familjes vazhdoi shkollën e lartë në Itali, në Universitetin e mirënjohur të Padovës, në degët e Kimisë Industriale e të Farmacisë, të cilat i mbaroi shkëlqyeshëm, përkatësisht, në vitet 1937 dhe 1939. Ai qw student, e më pas, ishte edhe mik i kimistit të njohur italian Menegini, autor tekstesh dhe punimesh në fushën e kimisë industriale. Pas diplomimit bëri një vit specializim në fabrika të ndryshme për sheqerin në qytetin e vogël Bondeno, në provincën e Ferrarës. Ju propozua nga Universiteti i Padovës të punonte në atë Universitet, por nuk pranoi dhe u kthye në Shqipëri. Sapo erdhi punoi si farmacist e mw pas si inxhinier kimist në fushën e teknologjisë së materialeve të ndërtimit, në Fabrikën e Çimentos në Shkodër, fabrika e vetme e çimentos e ndërtuar para lufte në vend nga një firmë gjermane. Këtu i erdhi një propozim nga firma e njohur italiane *Montecatini* për të filluar si inxhinier në Itali, por ai nuk pranoi.



Në periudhën e fashizmit u arrestua si antifashist dhe u burgos në Shqipëri e Itali e pas këtyre burgimeve u internua në ishullin famëkeq të Ventotenes (shkurt 1940). Pas lufte, që në vitin e parë të Çlirimit filloi dhe vuri në punë

Fabrikën e Çimentos në Shkodër. Në këtë fabrikë u arrit të prodhohej çimento e cilësisë standarde, e cila u përdor edhe në rindërtimin e urave të shkatërruara gjatë luftës. Vënia në punë e fabrikës është bërë në kushte mjaft të vështira, e megjithatë Ernesti arriti rezultate të mira dhe prandaj transferohet në Tiranë. Këtu punoi së pari në laboratorin e parë kimik ushqimor. Më vonë vazhdoi punën në Laboratorin e Kërkimeve Industriale, në Institutin e Kërkimeve Industriale, në Institutin e Gjeologjisë e të Minierave e më vonë në Institutin e Studimeve e Projekttimeve të Teknologjisë Kimike, deri sa doli në pension. Në këto institute Ernesti zhvilloi aktivitetin më të madh të tij, të lidhur kurdoherë me qendrat industriale në të gjithë Shqipërinë, në fushat e industrisë së lehtë, ushqimore dhe të mineraleve.

Me përgatitje serioze teorike, por edhe me sensin e hollë praktik e vullnetin për profesionin, E. Bushati ka dhënë ndihmesë të shquar në studimin, projektimin dhe vënien në shfrytëzim të mjaft linjave prodhuese të cilat përbënin fillesat e industrisë kimike në vendin tonë. Ai është një nga themeluesit e të parit institut kërkimor në fushën e industrisë, Institutit të Kërkimeve Industriale në Tiranë, ku për shumë vite drejtoi sektorin e prodhimeve të reja kimike.

Ndër aspektet kryesore të veprimtarisë së tij të gjerë kërkimore-shkencore e zbatuese, në fushën e kimisë industriale mund të përmenden: 1) Studimi, projektimi dhe vënia në shfrytëzim e linjës së prodhimit të bojërave të dheut, Tiranë. 2) Studimi, projektimi dhe vënia në shfrytëzim e linjës së prodhimit të bojërave të vajit dhe smalto, Tiranë. 3) Studimi, projektimi e shfrytëzimi i kripores së Salavecit në Vlorë. 4) Studimi i vendburimeve argjilore të vendit dhe rekomandimet për shfrytëzimin industrial të tyre. 5) Studimi, projektimi dhe ndërtimi i banjës elektrolitike me katodë mercuri për prodhimin e klorit e të sodës kaustike, pranë ndërmarrjes kimike, Tiranë. 6) Prodhimi i sulfatit të bakrit nga mbeturinat e uzinës së telave të bakrit në Shkodër. 7) Studimi i lëndëve të para fosfatike të vendit dhe hartimi i skemave teknologjike të pasurimit të tyre. 8) Studimi e hartimi i skemave teknologjike të prodhimit të mikroplehrave dhe eksperimentimi laboratorik i prodhimit të tyre. 9) Studimi dhe përpilimi i skemave teknologjike për prodhimin e hidrogjenfosfatit të kalciumit për tu përdorur si ushqim në pularitë. 10) Studimi për zëvendësimin e kripës së detit me kripë guri të Dhrovjanit, për tu përdorur si lëndë e parë në Uzinën e Sodës së Kalcinuar e Kaustike, Vlorë. Në të gjitha këto studime e veprimtari prodhuese spikat gjykimi i pjekur i profesionistit me kualifikim të lartë shkencor.

Një ndihmesë të çmuar ka dhënë E. Bushati edhe në zhvillimin e arsimit të lartë në vend, për përgatitjen e specializimin e kuadrove të reja në fushën e

kimisë industriale, si në procesin universitar, ashtu edhe pasuniversitar. Ai është ndër themeluesit e degës së Kimisë Industriale më 1957, në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Shkencave Natyrore, si dhe pedagogu i parë i lëndës së Teknologjisë Kimike Inorganike gjatë viteve 1959- 1968 deri sa u la këtë lëndë pedagogëve të rinj efektivë.

Krahas me krijimin e traditës së mësimdhënies në universitet, ai çau rrugën duke udhëhequr me kompetencë diplomantët e parë të kimisë industriale, si dhe duke qenë pjesëmarrës i përhershëm i komisionit të mbrojtjes së diplomave. Në këtë mënyrë, ai dha ndihmesë të drejtpërdrejtë në përgatitjen e plejadës së parë të specialistëve të lartë të kimisë industriale që drejtuan më pas industrinë tonë. Për më tepër, ai qe udhëheqës me nivel të lartë metodik e shkencor për disertacionet e para të mbrojtura në vend në fusha të ndryshme të kimisë industriale, duke përfshirë edhe pedagogët e rinj të lëndës teknologjia kimike inorganike (Dh. Haxhimihali e R. Pinguli). Disertantët e udhëhequr nga Prof. E. Bushati vazhduan më pas rrugën e tij, duke arritur të drejtojnë katedra dhe sektorë shkencorë e të prodhimit kudo në vendin tonë. Mjaft prej tyre u bënë studiues e profesorë të njohur.

Ernest Bushati është autor i dhjetëra punimeve shkencore, si dhe ka botuar më 1980 një libër 'Kloruri i natriumit dhe derivatet e tij'. Për kontributin e shquar pedagogjik e shkencor, E. Bushatit ju dha titulli shkencor docent (viti 1965), si dhe ka fituar Çmimin e Republikës.

Ernest Bushati vdiq në Tiranë, më 14 janar 1993. Ai la gjurmë të pashlyeshme në shkencën dhe industrinë shqiptare, si shkencëtar i talentuar e i përkushtuar. Njëherazi, profesor Ernesti ishte pedagog i talentuar, e mbi të gjitha, njeri fisnik që kurdoherë ishte i gatshëm për tu dhënë ndihmë të pakursyer nxënësve e kolegëve të tij të rinj e për këtë meritoi admirimin e tyre të paharruar.